

Tiranë, nëntor 2024

KONSULTIMI PUBLIK: PRAKTIKAT E MIRA NDËRKOMBËTARE, GJETJE DHE REKOMANDIME PËR STANDARDET E APLIKIMIT NË KUVENDIN E RSH¹

(Dokument Pune)

¹ Ky dokument i Institutit të Studimeve Politike (ISP) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien në përmbushje të kriterëve të Grupit të Parë të Kapitujve Negociues - Cluster 1”, zbatuar nga tri organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Instituti për Studimet, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë. Përgjegjësia është vetëm e ISP.

KONTEKSTI POLITIK

Në muajin tetor 2024 Shqipëria hapi zyrtarisht kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian. Tashmë Shqipëria ka hyrë në një fazë të re, duke mbyllur periudhën e tranzicionit dhe duke i vlerësuar jo më si premtim por si kusht thelbësor jetësimin e plotë të standardeve të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst dhe në nevojën për akte konkrete kundër korrupsionit dhe abuzimit, si dhe në drejtim të mirëqeverisjes efektive, parime të tilla si transparencja, llogaridhënia institucionale, përgjegjësia publike, pjesëmarrja qytetare dhe integriteti i procesit vendimmarrës dalin në krye të prioriteteve institucionale.

Kuvendi i RSH, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit, është institucioni kryesor vendimmarrës dhe kushtetues, tribunë e debatit politik dhe procesit legjislativ, kontrollues mbi pushtetin ekzekutiv, ushtrues i mbikëqyrjes së institucioneve të tjera dhe identifikimit me vullnetin politik periodik qytetar. Aktualisht legjislatura parlamentare ka hyrë në vitin e fundit të mandatit kushtetues, në maj 2025 në Shqipëri mbahen zgjedhjet e reja parlamentare. Linjat prioritare paralele, nevoja për sukses në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe nevoja për të udhëhequr procesin e integritetit, i cili është afatgjatë dhe zgjedhjet janë vetëm një pjesë e tij, në rastin e një elite politike të maturuar dhe vizionare mund të gjejnë pika takimi dhe ecurie pa ndërhyrje/zhvendosje. Përvojat e të kaluarës së shkuar dhe të afërt na dëshmojnë se konfliktualiteti politik dhe synimet elektorale ecin në drejtim të kundërt, duke dobësuar rolin e parlamentit, standardet e transparencës dhe llogaridhënies si dhe vetë angazhimin institucional real mbi sfidat e integritetit.

Kuvendi ka rol thelbësor në procesin e negociatave për anëtarësim, por edhe detyrime që burojnë nga ky proces. Një prej tyre është edhe jetësimi efektiv i procesit të konsultimit dhe transparencës publike. Janë dy motive thelbësore për këtë proces: së pari, stadi i ri ku ka hyrë Shqipëria dhe përgjegjësitë gjatë negociatave për të jetësuar standardet e një vendi kandidat real, dhe së dyti, fakti se legjislacioni mbi konsultimin publik, ashtu si ai për të drejtën e informimit, këtë vit shënojnë 10 vjetorin e tyre, - një rast i mirë për të analizuar sukseset dhe problematikat dhe për të përmirësuar instrumentet ligjore, politike dhe administrative për të ardhmen.

RAPORTI I BE 2024 MBI SHQIPËRINË PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë (2024) përbën një piketë vlerësimi dhe adresimi me rëndësi. Raporti vlerësonte ndër të tjera se ndër kritikatat ndaj nivelit të funksionimit të institucioneve demokratike është mungesa e konsultimeve domethënëse publike. Sipas raportit, kjo është një nga disa faktorë që ka dobësuar më tej efektivitetin, transparencën dhe objektivitetin e punës parlamentare. Duke u ndalur te Kuvendi raporti vlerëson se zbatimi nga



Parlamenti i kuadrit ligjor për proceset e konsultimit publik mbetet formal dhe se nuk krijohet gjithnjë mundësia për konsultim brenda afateve të arsyeshme dhe në mënyrë transparente².

Raporti i BE analizon dhe vlerëson standardet aktuale të konsultimit jo vetëm në parlament, por edhe në disa institucione dhe fusha specifike, nga media, shoqëria civile dhe deri tek legjislati i posaçëm mbi biznesin, pronësinë apo mjedisin. Disa nga vlerësimet dhe rekomandimet e tjera të raportit të BE-së janë:

- *Kuadri ligjor për konsultimet publike është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, por konsultimet mbeten kryesisht formale;*
- *Pavarësisht përmirësimeve në konsultimin me palët e interesuara gjatë periudhës raportuese, përfaqësuesit e biznesit vazhdojnë të kenë shqetësime serioze për nivelin e konsultimit publik nga qeveria.*
- *Përqindja e akteve ligjore që kalojnë në konsultim publik duhet të rritet më tej, bazuar në një interpretim më të plotë të kritereve në ligjin për konsultimin publik.*
- *Shqyrtimi publik i aktivitetit të qeverisë mbetet i dobët dhe përdorimi i shtuar i procedurave të përshpejtuara kufizon mundësinë për shqyrtim parlamentar mbi vendimmarrjen e saj.*
- *Kontrolli i cilësisë së konsultimeve duhet të forcohet dhe të sigurohet ndjekja e duhur. Nevojiten më shumë veprime për të inkurajuar palët e interesuara për pjesëmarrje, në veçanti shoqërinë civile.*
- *Kuadri rregullator për median duhet t'i nënshtrohet konsultimeve të gjera me organizatat e medias dhe shoqërinë civile bazuar në një dialog të strukturuar dhe gjithëpërfshirës.*
- *Legjislati mbi pakicat duket plotësuar dhe zbatuar duke mbetur i hapur për konsultim të gjerë publik.*
- *Përfaqësuesit e biznesit vazhdojnë të kenë shqetësime serioze mbi procesin e konsultimit publik (për shembull, për periudha të shkurtra konsultimesh dhe mos reflektim të komenteve të propozimeve në projektligje/masa).*
- *Rregullat ekzistuese për konsultimet publike dhe rregullat e VNR-së nuk zbatohen ende për legjislatin dytësor.*
- *Ndryshimet e fundit në Ligjin për Zonat e Mbrojtura janë bërë pa u konsultuar me palët e interesuara.*

²Shih: Albania 2004 Report. SWD(2024) 690, në linkun: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en



KONSULTIMI NË FOKUSIN E UDHËRRËFYESIT PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE

Kuvendi ka miratuar *Udhërrëfyesin për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike* bazuar në VKM nr. 611, datë 2.10.2024. Dokumenti strategjik do të duhet të adresojë në afate konkrete përgjegjësitë institucionale, problematikat dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre. Dokumenti merr vlerë të veçantë në kuadër të negociatave të kapitullit të parë me BE (Cluster One) dhe trajton çështjet prioritare politike në funksionimin e institucioneve, kryesisht Kuvendi dhe institucionet e lidhura me të.

Në këtë dokument citohet angazhimi se “*ndryshimet legislative në Kodin Zgjedhor brenda vitit 2026, përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak dhe vullneti politik dhe një procesi të hapur konsultimi gjithëpërfshirës*”³. Vlen të theksohet se konsultimi për ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor mungoi tërësisht, formalisht dhe praktikisht.

Udhërrëfyesi përdor të njëjtin vlerësim dhe standard edhe për çështje konkrete të legjislacionit zgjedhor, siç është nevoja për rregullime ligjore në fushën e medias dhe në financimin/transparencën e financimeve elektorale.

Një angazhim tjetër në Udhërrëfyes është edhe ai lidhur me shoqërinë civile. Sipas dokumentit zyrtar, brenda vitit 2024 do të duhet të bëhet “publikimi, konsultimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të monitorimit për udhërrëfyesin 2019-2023 për krijimin e një mjedisi favorizues për OSHC-të”.

Udhërrëfyesi për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike gjithashtu përcakton:

- *Metodologjia e akteve që i nënshtrohen konsultimeve publike është rishikuar dhe miratuar brenda vitit 2030 duke zgjeruar fushën e konsultimit publik për aktet e qeverisë;*
- *Kuadri ligjor që do të ndryshohet për të siguruar përshtatjen e afatit të publikimit për konsultimin elektronik bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e nismave komplekse të politikave;*
- *Ndryshim në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, dhe në legjislacionin dytësor për konsultimin publik në mënyrë progresive drejt vitit 2030;*
- *Rriten kapacitetet e ministrive të linjës për të kryer konsultimet e duhura brenda vitit 2025;*
- *Kuvendi përmirëson mjetet digjitale për të siguruar një konsultim më të madh publik të duhur nga viti 2026 e në vijim;*

³ Shih: Fletore Zyrtare, nr.168, 2024. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 611, datë 2.10.2024, fq.19736-19741.



- *Rritja e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse me staf të kualifikuar dhe të mirëtrajnuar si kusht për zgjerimin e procesit të konsultimit publik në legjislacionin dytësor me interes të lartë publik deri në vitin 2030.*

Në reflektim të këtyre angazhimeve pritshmëritë e Udhërrëfyesit janë:

- *Cilësia e konsultimeve, transparenca dhe pjesëmarrja publike e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse përmirësohet duke u drejtuar në mënyrë proaktive dhe plotësisht gjithëpërfshirëse, dhe shtrirë në të gjitha iniciativat legjislative dhe politike duke u realizuar përmes mekanizmave efektive institucionale dhe për një dialog brenda vitit 2025;*
- *Forcimi i kulturës pjesëmarrëse të publikut dhe palëve të interesuara, si dhe rritja e llogaridhënies së institucioneve në vendimmarrje përmes konsultimit publik, që çon në rregullime më të mira brenda vitit 2026;*
- *Administrata publike në Qendrën e Qeverisjes është e aftë të kryejë procesin e konsultimit publik bazuar në standardet më të larta – në vazhdim;*
- *Afati i publikimit për konsultimin elektronik respektohet së paku në nivelin 90%;*
- *Shoqëria civile konsultohet plotësisht dhe merr pjesë në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse në negociatat e anëtarësimit në BE nga viti 2025.*



KUVENDI RSH, KORNIZA LIGJORE DHE KONSULTIMI PUBLIK: GJETJE DHE REKOMANDIME

Koncepti i “konsultimit publik” është relativisht i ri në Shqipëri. Më 2014 u miratua ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligj i cili synonte “rregullimin e procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik”⁴. Ligji përcaktoi se termi “konsultim publik”, do të thotë, *“është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt-aktit, nga momenti i publikimit të projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij”*. Ligji 119/2014 për të drejtën e informacionit dhe ai 146/2014 për konsultimin publik shënuan një fazë të re në raportin dhe standardet e synuara të transparencës dhe llogaridhënies publike.

Përgjatë një dekade ka pasur raste pozitive dhe negative të konsultimeve publike, por në tërësi procesi ka mbetur ende larg standardeve të përcaktuara nga ligji, pritshmërive publike dhe nevojave që ka vendi për të jetësuar demokracinë funksionale dhe shtetin e së drejtës. Institucionet, përfshirë Kuvendi i RSH, kanë krijuar platforma online të konsultimit, kanë miratuar dokumente referuese dhe manuale, kanë raporte vjetore dhe dokumente strategjike, aplikojnë proceduralisht kriterin e konsultimit publik dhe zyrtarët drejtues bëjnë thirrje publike për pjesëmarrje në konsultime. Disa prej këtyre instrumenteve në retrospektivë mund të shihen si zhvillime pozitive, por stadi i zhvillimit, ndryshimet teknologjike, nevojat e vendit dhe raporti në ndryshim midis shtetit dhe qytetarit, mund të rekomandojë ridimensionimin e procesit dhe reflektimin strategjik drejt sfidave të reja.

Parimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje konsiderohen si elemente thelbësore për çdo sistem politik të përgjegjshëm dhe demokratik. Përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse demokratike e sjell publikun më pranë të zgjedhurve të tyre dhe krijon mundësinë që ata të adresojnë probleme e të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme.

Konsultimi me publikun, si një ndër mekanizmat për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen parlamentare, është tashmë një tipar i pranuar dhe i pritshëm i procesit demokratik. Në këtë kontekst, edhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i ka kushtuar rëndësi gjithëpërfshirjes në vendimmarrje duke parashikuar si objektiv strategjik të tij *“Rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe publikut në procesin legjislativ, kontrollin parlamentar dhe aktivitete të tjera parlamentare”*⁵.

⁴ Shih: Ligji 146/2014, në linkun: <https://dptv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

⁵ Shih: Plani Strategjik i Kuvendit 2020-2025, në linkun:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202301301131337119Plani%20Strategjik%20i%20Kuvendit%202020-2025.pdf>



Kuvendi zyrtarisht ka deklaruar se rritja e përgjegjshmërisë, produktivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së tij përpara qytetarëve do të jenë prioritet i Kuvendit (2024), dhe këtij objektivi do t'i shërbejë edhe arritja e Standardeve të Transparencës në zbatim të angazhimit të Kuvendit për të qenë pjesë e Rrjetit të Parlamenteve të Hapura; implementimi i Platformës së re të Konsultimit Publik dhe cikli i sesioneve “Dialog për Konsensus”, përmes të cilit deputetët do të informojnë publikun mbi projektligje të shqyrtuara në Kuvend me interes të veçantë për publikun⁶. Midis premtimeve dhe qëndrimeve zyrtare dhe akteve konkrete në procesin parlamentar vijon të ketë hendek të dukshëm dhe ky është një prej rasteve të prekshme.

Fakti është se shumica e akteve dhe instrumenteve të krijuara nga institucionet, përfshirë Kuvendi, *de facto* kanë prodhuar akses të kufizuar, nuk ofrojnë mundësi kohore dhe praktike të konsultimit publik dhe shfaqin mangësi thelbësore ndaj standardeve të përcaktuara nga legjislacioni.

Zyrtarët përgjegjës në nivel administrativ që mbulojnë çështjet e konsultimit janë kryesisht zyrtarë të marrëdhënieve publike që “kanë një detyrë tjetër shtesë”, ose zyrtarë që e shohin procesin si proces rutinor dhe statik, pa ndërveprim dhe pa vlerësim periodik, ndërkohë që rolin kryesor në elementët e transparencës e luan pjesa politike vendimmarrëse e Kuvendit, organet drejtuese në Kuvend, në komisione dhe në grupet parlamentare. Vullneti politik përfaqëson faktorin kryesor për suksesin ose dështimin e procesit, pavarësisht se konsultimi, sipas legjislacionit, do të duhej të ishte procedurë teknike deri në fazën fundore të vendimmarrjes politike.

Instituti i Studimeve Politike (ISP), ashtu si organizata të tjera aktive të shoqërisë civile, si KShH, IDM, Faktoje, BIRN, AIS, QQ, etj, kanë ngritur dhe adresuar vazhdimisht shqetësime lidhur me mangësitë e procesit konsultues në parlament (konsultimi mbi aktet në shqyrtim) dhe nga parlamenti në raport edhe me institucionet e tjera (procesi i mbikëqyrjes parlamentare).

Gjetjet kritike të shoqërisë civile janë konfirmuar edhe nga raportet ndërkombëtare, pjesërisht edhe nga vetë Kuvendi. Botimet parlamentare (raportet vjetore) mbi procesin e konsultimit dhe pjesëmarrjes publike të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera, janë kryesisht statike, evitojnë analizën e thelluar dhe reflektimin ndaj kritikave dhe nxjerrin në pah vetëm anën pozitive të punës së institucionit.

⁶ Shih: Kuvendi i RSH. Prioritetet e sesionit parlamentar, në linkun:: <https://www.parlament.al/lajme/ff5f7832-7bb9-4420-a892-1975008f3baf>

KONSULTIMI PUBLIK NË KUVENDIN E RSH

Në shumicën e vendeve procesi i konsultimit publik rregullohet me ligj dhe rrallëherë me legjislacion sekondar. Një kuadër ligjor është parësor për të mundësuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në veprimtarinë parlamentare.

Janë aktet ligjore si kushtetuta, ligjet, rregullat e procedurës së parlamentit apo edhe akte të brendshme të tij ato që krijojnë mundësinë për shoqërinë civile, akademikët, ekspertët dhe publikun në përgjithësi për t'u angazhuar sistematikisht në punën parlamentare.

Në këtë kontekst, procesi i konsultimit publik në Kuvend rregullohet nga akte të brendshme, të cilat u vijnë në ndihmë deputetëve dhe shërbimeve të Kuvendit, për të përgatitur, planifikuar, organizuar, kryer dhe raportuar për procesin e konsultimit publik të projektakteve legjislative apo çështjeve të tjera të shtruara për konsultim. Kuadri rregullator përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

- Rregullorja e Kuvendit të RSH⁷;
- Vendim nr. 20, datë 20.05.2022 i Byrosë së Kuvendit “Manuali i Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit”⁸;
- Vendim nr. 50, datë 13.05.2020 i Byrosë së Kuvendit “Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së hapur të Kuvendit”⁹.

Kuvendi, nëpërmjet kuadrit rregullator të mësipërm, ka përcaktuar edhe mekanizmat ligjorë të mëposhtëm (metodat e konsultimit) për të realizuar pjesëmarrjen e publikut/palëve të interesuara (kryesisht për sa i përket procesit legjislativ) në vendimmarrjen parlamentare. Është përgjegjësi e Kuvendit që nëpërmjet mekanizmave tu krijojë mundësinë qytetarëve dhe palëve të interesuara që të marrin pjesë në procesin e konsultimit.

- Platforma online e konsultimit publik¹⁰ (konsultimi elektronik);
- Seanca dëgjimore;
- Me postë apo email në adresë të koordinatorit për grupet e interesit ose në adresë të komisioneve parlamentare që shqyrtojnë projektligjin (njoftim tradicional).

⁷ Shih: Rregullorja e Kuvendit të RSH, neni 36, në linkun:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/RregullorjaeKuvenditeperditesuar.pdf>

⁸ Shih: Manuali i Pjesëmarrjes së Publikut në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit”, në linkun:

[https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%CC%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20ne%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20\(2\).pdf](https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%CC%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20ne%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20(2).pdf)

⁹ Shih: Rregullore për funksionimin dhe organizimin e veprimtarisë së hapur të Kuvendit, në linkun:

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202212261848006143Rregullore%20per%20organizimin%20dhe%20funksionimin%20e%20veprimtarise%20se%20hapur%20te%20Kuvendit.pdf>

¹⁰ Shih në linkun: <https://konsultimi.parlament.al/>



Instrumenti kryesor është platforma *online* e konsultimit publik e cila u mundëson qytetarëve përfshirjen në proceset parlamentare (legjislativ, mbikëqyrës etj) me dhënien e komenteve, sugjerimeve, opinioneve dhe mendimeve të tyre për çështje që shtrohen në konsultim publik nga Kuvendi¹¹.

KiE¹² dhe OKB¹³ përcaktojnë në mënyrë specifike disa parime dhe kërkesa kryesore relevante që duhet të ndiqen në procesin e konsultimit publik.

Referuar këtyre akteve procesi i konsultimit publik **kërkon nga autoritetet publike** sa vijon:

- (1) publikut t'i jepet mundësia për të marrë pjesë në hartimin e rregullave, politikave, ligjeve dhe vendimeve që i afektojnë ato;
- (2) publikut t'i mundësohet pjesëmarrja në vendimmarrje qysh në fazat e hershme;
- (3) publikut t'i ofrohet informacion i mjaftueshëm rreth procedurave për pjesëmarrjen e publikut;
- (4) publikut t'i ofrohet dokumenti i konsultimit i shoqëruar me informacion të mjaftueshëm, të qartë dhe të kuptueshëm për të lejuar pjesëmarrjen efektive në vendimmarrje;
- (5) publikut t'i ofrohet kohë e arsyeshme për dhënien e komenteve dhe/ose sugjerimeve;
- (6) publiku të informohet për vendimet e marra dhe nëse janë marrë parasysht komentet e tyre;
- (7) mjetet juridike të jenë të disponueshme kur kërkesat e pjesëmarrjes së publikut nuk plotësohen;
- (8) pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndjekë të njëjtat parime që rregullojnë edhe pjesëmarrjen jo elektronike.

Referuar kornizës rregullatore të konsultimit publik elektronik në Kuvend, zbatimit të saj në praktikë dhe standardeve ndërkombëtare të sipërcituara rezulton se procesi i konsultimit publik nëpërmjet platformës online karakterizohet nga një përputhshmëri jo e plotë me parimet dhe modelet ndërkombëtare:

¹¹ Platforma është funksionale vetëm përsa i përket publikimit të dokumentit të konsultimit nga Kuvendi. Regjistrimi i publikut në platformë si dhe hedhja e komenteve apo sugjerimeve është teknikisht e pamundur. ISP u regjistrua lehtësisht në platformën e parlamentit argjentinas dhe në platformën e Komisionit Evropian vetëm duke përdorur dy të dhëna: adresën e postës elektronike dhe emër/mbiemër.

¹² Shih: Code of Good Practice for Civil Participation in the Decision-Making Process (Revised) (2019) – Këshilli i Evropës, në linkun: <https://rm.coe.int/reviced-code-of-qood-practice-for-civil-participation-in-the-decision-/1680980cb1>

¹³ Shih: Guidelines for States on the Effective Implementation of the Right to Participate in Public Affairs – United Nations, Office of the High Commissioner for Human Rights 2018, në linkun: https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/PublicAffairs/GuidelinesRightParticipatePublicAffairs_web.pdf etj.

- (1) dokumenti i konsultimit nuk shoqërohet me një informacion të detajuar dhe në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të lehtësuar pjesëmarrjen efektive në vendimmarrje¹⁴;
- (2) publikut nuk i ofrohet asnjë informacion orientues rreth procedurave për dhënien e komenteve/sugjerimeve/mendimeve¹⁵. Një manual përdorimi i publikuar në platformë është mëse i nevojshëm;
- (3) komentet e dhëna për dokumentin e konsultimit nuk janë publike¹⁶;
- (4) komentet kërkohen në formën e teknikës legjislative¹⁷;
- (5) kategoritë e çështjeve që i nënshtrohen konsultimit publik janë të paqarta¹⁸;
- (6) nuk përcaktohen subjektet që autorizojnë këtë konsultim¹⁹;
- (7) nuk përcaktohet afat për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve²⁰;
- (8) platforma nuk jep asnjë statistikë në lidhje me: komentet (në total), numrin e komenteve nga individë, OSHC apo lobist, si dhe subjektet më aktivë ndonëse kjo (referuar kuadrit rregullator) është e detyrueshme²¹;
- (9) platforma nuk jep asnjë informacion për marrjen parasysh ose jo të komenteve të dhëna²²;

¹⁴ Referuar praktikës së huaj ndërkombëtare publikimi i projektligjit shoqërohet me një informacion të shkurtër, të thjeshtë dhe të kuptueshëm për publikun rreth rregullimit aktual ligjor të çështjes dhe se si mund të rregullohet më mirë me ndryshimet ligjore. Cilësia e dokumenteve të konsultimit përcakton cilësinë e kontributeve të marra nga publiku dhe rrjedhimisht cilësinë e kontributit në politikëbërje. Vështirësia në paraqitjen e komenteve rritet akoma më shumë në rastet e shesave dhe ndryshimeve në ligj.

¹⁵ Platforma përmban vetëm një mesazh mirëseardhjeje ndërkohë që referuar praktikës së huaj parlamentet publikojnë në platformën e konsultimit publik një informacion të detajuar rreth procedurave për regjistrim dhe hedhjen e komenteve të tyre (manual përdorimi).

¹⁶ Referuar praktikës së huaj, parlamentet publikojnë çdo mendim/sugjerim/koment apo rekomandim të subjekteve pjesëmarrëse në procesin e konsultimit.

¹⁷ Referuar praktikës ndërkombëtare në asnjë rast publikut nuk i kërkohet që komentet të jenë sipas rregullave të teknikës legjislative. Kjo vështirëson së tepërmi komunikimin me publikun dhe e largon këtë të fundit nga parlamenti.

¹⁸ Manuali për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje përmend projektligjin por konsultimit publik i janë nënshtruar edhe raportet vjetore të veprimtarisë së institucioneve të pavarura apo edhe dokumente të administratës sikurse Plani Strategjik i Kuvendit apo Standartet dhe indikatorët për një parlament të hapur.

¹⁹ Për projektligjin vendos komisioni i përhershëm parlamentar ndërsa për çështje të tjera të cilat nuk janë objekt shqyrtimi nga komisionet parlamentare nuk është e qartë cili është subjekti autorizues. P.sh., për Planin Strategjik të Kuvendit 2020-2025 apo për Standartet dhe indikatorët për një parlament të hapur.

²⁰ Referuar praktikës së huaj afati është i mirëpërcaktuar.

²¹ Referuar praktikës së huaj platforma të tilla paraqesin një sërë statistikash lidhur me procesin e konsultimit publik për çështjen në konsultim.

²² Është thelbësore për ata që marrin pjesë në konsultimin publik që të dinë se si dhe në çfarë mase është marrë parasysh kontributi i tyre si dhe të kuptojnë pse disa sugjerime nuk mund të merren në konsideratë. Ndonëse referuar Urdhrit të Brendshëm të Sekretarit të Përgjithshëm "Për standardizimin e formatit të raportit të komisioneve për projektligjet" (nr. 29/2019) komisioni ka detyrimin për të reflektuar në raportin e tij (në mënyrë të përmbledhur) opinionet/sugjerimet/prendimet e grupeve të interesit dhe/apo shoqërisë civile dhe sa prej tyre janë pranuar nga komisionet, ky i fundit (raporti) jep informacion të cekët dhe këtë në fund të procesit. P.sh., shih raportin e komisionit për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar" në

linkun: <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202405020627093876Raport%20KVPTM.pdf>

*(10) një informacion mbi mbrojtjen e të dhënave personale të komentuesve është i nevojshëm*²³.

Për sa më sipër, zbatimi i plotë i standardeve ndërkombëtare ende nuk është i garantuar dhe kjo kërkon angazhim të mëtijshëm nga Kuvendi.

Funksionalitetet e platformës kanë nevojë të përmirësohen më tej duke përdorur modalitete të reja teknologjike, për ta bërë më të lehtë për publikun dhe palët e interesit që të marrin pjesë në këto konsultime dhe rrjedhimisht për të pasur një proces efektiv konsultimi. Sikurse ka theksuar edhe Unioni Ndërparlamentar *“Angazhimi publik në vendimmarrje sjell përfitime por përfitimet vijnë vetëm kur ky proces bëhet mirë. Një angazhimi i dobët mund të jetë kundërproduktiv. Nëse angazhimi shihet si sipërfaqësor, ose nëse shqetësimet publike kërkohen por nuk trajtohen në mënyrë efektive, njerëzit mund të zhgënjehen dhe të largohen më shumë nga parlamenti.”*²⁴.

²³ Referuar modeleve ndërkombëtare kjo çështje zë një vend të veçantë.

²⁴ Shih: *Global Parliamentary Report 2022 Public engagement in the work of parliament* fq. 37 cit. në linkun: <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2022-03/global-parliamentary-report-2022>



MODELE DHE PËRVOJA NDËRKOMBËTARE E KONSULTIMIT PUBLIK

Sistemet apo platformat elektronike ofrojnë potencial të madh për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Ato mund të kontribuojnë në masë të madhe në transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e institucioneve, në promovimin e angazhimit të qytetarëve dhe në rritjen e fuqizimit, aksesit dhe gjithëpërfshirjes së procesit demokratik. Këto sisteme thellojnë pjesëmarrjen politike duke u mundësuar qytetarëve të lidhen me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur. ISP në vijim paraqet disa modele të mira të platformave elektronike të cilat janë krijuar dhe funksionojnë në pajtim me kërkesat dhe parimet ndërkombëtare dhe që parlamentet apo qeveritë në botë i përdorin për konsultimin me publikun.

Komisioni Evropian - Platforma “Have your say”²⁵

Sipas nenit 11 të Traktatit për Bashkimin Evropian²⁶, Komisioni Evropian (KE) ka për detyrë të kryejë konsultime të gjera me palët e interesuara për të siguruar që veprimet e BE-së të jenë koherente dhe transparente. Gjithashtu një marrëveshje ndërinstitucionale²⁷ midis Parlamentit Evropian, Këshillit të BE-së dhe Komisionit Evropian parashikon konsultimin publik edhe nëpërmjet internetit në procesin e ligjvënies. Në këtë kontekst, KE ka ofruar mundësi për qytetarët që të marrin pjesë (në mënyrë elektronike) në proceset e politikvënies së Bashkimit Evropian. Aktualisht konsultimi publik realizohet nëpërmjet portalit “Have your say” i cili i ofron mundësinë qytetarëve për të ndarë opinionet/pikëpamjet e tyre për politikat e reja të BE-së dhe legjislativës në fuqi. Në vitin 2021, KE miratoi dokumentin “Udhëzime për rregulla më të mira” në të cilin përcaktohen kërkesat dhe detyrimet që duhen ndjekur në të gjithë ciklin e politikave. Ndër të tjera ky dokument përfshin norma në lidhje me procesin e konsultimit me palët e interesuara nëpërmjet platformës së mësipërme²⁸ dhe sipas të cilave: konsultimi është i detyrueshëm; dokumentet për konsultim duhet të jenë të qarta dhe sa më të kuptueshme për publikun; afatin e konsultimit; komentet/sugjerimet/rekomandimet e dhëna publikohen; një përmbledhje e shkurtër mbi çështjet kryesore të ngritura në konsultim gjithashtu publikohet; komentet analizohen dhe një raport që përshkruan rezultatet e përgjithshme të konsultimit (raporti i përmbledhës) publikohet në faqen e internetit të konsultimit. Platforma jep udhëzime të thjeshta dhe të kuptueshme mbi përdorimin e saj.

²⁵ Shih platformën në linkun: https://ec.europa.eu/info/laë/better-regulation/have-your-say_en

²⁶ Shih: Traktatin e BE-së në linkun: https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC_1&format=PDF

²⁷ Shih marrëveshjen në linkun: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016Q0512\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32016Q0512(01))

²⁸ Shih: Guidelines for better regulations, KE, 2021 në linkun: https://commission.europa.eu/system/files/2021-11/sëd2021_305_en.pdf



Hollanda, (Qeveria dhe Parlamenti) - Platforma <https://www.internetconsultatie.nl>²⁹

Platforma jep informacione mbi legjislacionin e hartuar nga qeveria apo parlamenti, për të cilën kërkohet mendimi i publikut përpara se Këshilli i Shtetit të vlerësojë propozimin legjislativ dhe debatin parlamentar. Ministritë dhe Dhoma e Përfaqësuesve kryejnë gjithashtu konsultimet e tyre nëpërmjet kësaj Platforme. Platforma e filluar si projekt pilot në vitin 2011 vazhdon edhe sot e kësaj dite duke vërtetuar se është një instrument i dobishëm dhe plotësues i praktikës ekzistuese të konsultimit në procesin legjislativ. Platforma i siguron publikut, OSHC-ve dhe institucioneve informacion mbi legjislacionin që është duke u përgatitur dhe u mundëson atyre të bëjnë sugjerime për të përmirësuar cilësinë dhe fizibilitetin e këtyre propozimeve. Platforma jep informacion të detajuar rreth përdorimit të saj, informacion të shkurtër dhe të kuptueshëm mbi projektaktin, komentet e bëra rreth tij, datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimit, raport mbi përfshirjen e propozimeve në tekstin e projektligjit etj.

Italia - Platforma qeveritare partecipa.gov.it³⁰

Sipas Dekretit Legjislativ nr. 82/2005³¹, të gjitha organet publike duhet të inkurajojnë të gjitha format e përdorimit të teknologjive të reja për të promovuar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në proceset demokratike. Në këtë kontekst, ka gjetur përdorim konsultimi publik paraprak në mënyrë elektronike. Çështja e konsultimit publik rregullohet me Direktivën nr. 2, datë 31 maj 2017 “Udhëzues për konsultimin publik në Itali”³², miratuar nga Departamenti i Administratës Publike në përputhje me kuadrin ligjor. Platforma jep udhëzime të qarta mbi përdorimin e saj dhe statistika të ndryshme mbi pjesëmarrësit në proces. Publiku mund të bëjë komente, të paraqesë propozime, të plotësojë formularin e paraqitur (pyetje-përgjigje) apo të marrë pjesë në debat. Dokumenti i konsultimit paraqitet edhe me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe të qartë për publikun.

²⁹ Shih platformën në linkun: <https://www.internetconsultatie.nl/>

³⁰ Shih platformën në linkun: <https://partecipa.gov.it/>

³¹ Shih nenin 9 të Dekretit legjislativ, në linkun:

<https://www.normattiva.it/atto/caricaDettaglioAtto?atto.dataPubblicazioneGazzetta=2005-05-16&atto.codiceRedazionale=005G0104&atto.articolo.numero=0&atto.articolo.sottoArticolo=1&atto.articolo.sottoArticolo1=10&qId=3852d637-1299-486e-90d0-edb068ed4a06&tabID=0.23888374410558022&title=lbl.dettaglioAtto>

³² Shih linkun: <https://www.gazzettaufficiale.it/eli/id/2017/07/14/17A04797/sq>



Gjermani, platforma shtetërore/publike: <https://bund.de>³³

Gjermania ka gjithashtu një traditë të konsoliduar të konsultimit publik, të database me të dhëna me interes publik, të pjesëmarrjes qytetare dhe grupeve të interesit. Bazuar në vlerësimin e OECD modeli gjerman ka një kuadër ligjor që rregullon “një sistem konsultimi që është afatgjatë, intensiv dhe i nxitur nga konsensusi”. Modeli gjerman përputhet me traditën politike, të pritur drejt konsensusit për vendimet e rëndësishme. Kuadri ligjor për konsultimin publik në Gjermani është përcaktuar në Rregulloren e Përbashkët të Procedurës, e cila zbatohet në nivel federal. Rregullat lënë hapësirë për fleksibilitet të konsiderueshëm sa i përket zbatimit të tyre. Ministritë përgjegjëse vendosin për kohën, qëllimin dhe përzgjedhjen e partnerëve të konsultimit, si dhe për zbatimin praktik të procesit të konsultimit. Normalisht, ministritë zhvillojnë raunde parakonsultimi, të cilat kryhen në një fazë të hershme përpara hartimit të një projektligji, ku përfshihen landet, bashkitë, komunitetin e ekspertëve dhe shoqatat, mbi bazën e dokumenteve kryesore. Rezultatet e këtij konsultimi kontribuojnë në draft projektligji, për të cilin të njëjtat palë më vonë konsultohen për herë të dytë. Këto procedura mund të kryhen me dorëzimin e draftit në letër ose në formë elektronike. Procesi i konsultimit në Gjermani për aktet ligjore zgjat rreth 4(katër) javë dhe është i rregulluar në aktet rregullatore të parlamentit dhe institucioneve përgjegjëse ekzekutive. Bazuar në praktikën gjermane, kulturën politike e shtetërore aty, është bërë tashmë pjesë e kulturës së komunikimit dhe vendimmarrjes lejimi i afateve të përshtatshme për konsultime për të mundësuar një vendimmarrje sa më efikase, të qëndrueshme dhe transparente.

Kroacia - Platforma qeveritare e-Savjetovanja³⁴

Konsultimi publik në Kroaci bazohet në Kodin e Praktikës për Konsultimin me Publikun e Interesuar në Procedurat e Miratimit të Ligjeve, Rregulloreve dhe Akteve të Tjera³⁵. Me miratimin e Kodit, Republika e Kroacisë iu bashkua grupit të demokracive të zhvilluara evropiane që kanë vendosur standarde dhe masa të qarta për konsultimin e organeve shtetërore me publikun e interesuar në procedurat e krijimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera, si dhe standardet dhe masat e parashikuara. Platforma jep shpjegime rreth përdorimit të saj. Regjistrimi dhe hapja e një llogarie në të përbën një efekt pozitiv në përdorimin e lehtë dhe efektiv të këtij portali. Të gjitha komentet e përdoruesve të regjistruar shfaqen për publikun duke mundësuar monitorimin e cilësisë së tyre. Në këtë mënyrë bëhet një analizë e shpejtë dhe efikase e të gjitha komenteve të marra dhe e raportimit mbi rezultatet e konsultimeve.

³³ Shih platformën e plotë në linkun: <https://verwaltung.bund.de/portal/>

³⁴ Shih platformën në linkun: <https://savjetovanja.gov.hr/>

³⁵ Shih Kodin në linkun:

<https://udruge.gov.hr/UserDocImages/userfiles/file/code%20of%20practice%20on%20consultation-croatia.pdf>



Platforma i nënshtrohet përmirësimit të vazhdueshëm të funksionaliteteve të saj në përputhje me nevojat e përdoruesve. Pjesëmarrja në konsultime është e gjerë dhe rezultatet e procesit paraqiten në raportin përmbledhës të konsultimeve. Çdo përdorues mund të njihet me këtë dokument dhe të shohë rezultatet e komenteve.

Estoni – Platforma qeveritare <https://eelnoud.valitsus.ee>³⁶ dhe platforma e iniciativave qytetare www.rahvaalgatus.ee³⁷

Platforma qeveritare në Estoni paraqet ciklin e plotë të procesit legjislativ tërësisht e aksesueshme për publikun. Të gjithë grupet dhe individët e interesuar mund të ndjekin procesin e politikëbërjes dhe të komentojnë gjatë të gjithë fazave, derisa projektakti të paraqitet në Qeveri. Estonia njihet si i vetmi vend ku hartimi i legjislacionit dhe proceset e koordinimit ndërministror janë tërësisht transparente. Një portal tjetër i iniciativave qytetare www.rahvaalgatus.ee mundëson paraqitjen e propozimeve për ndryshime në legjislacion pranë parlamentit si dhe jep mundësinë e ndjekjes së propozimit në të gjitha fazat e tij.

Lituani – Parlamenti: Seimas³⁸

Parlamenti i Lituaniës ofron për publikun shërbimet elektronike vijuese: e-petition, e-legislation dhe e-letters. Shërbimi e-legislation përfshin: regjistrimin e nismave legjislative të publikut; pranimin e komenteve dhe propozimeve lidhur me: aktet ligjore në fuqi dhe projektaktet ligjore të paraqitura, monitorimin e rregullimit ligjor dhe regjistrimin e nismave legjislative; dorëzimin e vërejtjeve, propozimeve dhe komenteve nga përdoruesit, vlerësimin e akteve dhe projektakteve ligjore nga përdoruesit e internetit me statistikat e vlerësimeve të ofruara. Faqja e Seimas jep udhëzime të qarta dhe të hollësishme për depozitimin e komenteve për projektligjin në sistemin e-legislation³⁹. Regjistrimi bëhet lehtësisht duke përdorur një adresë elektronike dhe password.

Gjeorgji, praktika e këshillave shkencorë me ekspertë: <https://matsne.gov.ge/>

Në një tjetër vend me status jashtë anëtarësisë në BE, Gjeorgji, praktika e konsultimit publik ka dallime por edhe disa elementë me interes publik nga modeli ynë dhe disa vendeve të BE-së. Për shembull, në Gjeorgji nuk ka ligj specifik për konsultimin publik, megjithëse ai rregullohet me Kushtetutë dhe rregullohet përmes disa ligjeve referuese.

³⁶ Shih platformën në linkun: <https://eelnoud.valitsus.ee/main#agq9oK9S>

³⁷ Shih platformën në linkun: www.rahvaalgatus.ee

³⁸ Shih platformën në linkun: https://www.lrs.lt/sip/portal.show?p_r=35386&p_k=2

³⁹ Shih Udhëzuesin "Si të paraqes komente për projektligjin", në linkun: https://www.lrs.lt/sip/getFile3?p_fid=37095

Në Gjeorgji gjatë seancave dëgjimore të komisioneve në Parlament palët e interesuara mund të përfshihen dhe të shprehin qëndrime për nismën legislative në shqyrtim. Rregullorja e Parlamentit të Gjeorgjisë përcakton krijimin e Këshillit Këshillimor Shkencor, që përbëhen nga “ekspertë-konsulentë profesionalë”, sipas fushave përkatëse. Ekzistenca e këtyre këshillave, krahas praktikës klasike të konsultimit publik, ndikon në nivelin e ekspertizës dhe informimit në fushën respektive. Komisionet nxisin pjesëmarrjen intelektuale dhe profesionale në zhvillimin e nismave legislative, hartimin e rekomandimeve bazuar në vlerësimet dhe konkluzionet e gjetura, promovon zhvillimin e mekanizmave efektivë të zbatimit të ligjit, bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare, me median dhe shoqërinë civile.

MODELE REFERUESE NGA VENDE TË AMERIKËS LATINE

Për shkak se shumë studime në fushën politike dhe të historisë së tranzicionit gjejnë pika takimi midis përvojave të vendeve ish-komuniste në Evropë dhe vendeve të Amerikës Latine, për qëllime informimi dhe referimi, ne kërkuam edhe përvojat aktuale në disa prej parlamenteve kryesore në Amerikën Latine, të cilat, krahas modelit të vendeve të BE, plotësojnë edhe më shumë pasqyrën e kornizës ligjore ndërkombëtare lidhur me procesin e konsultimit, sidomos atë parlamentar. Më poshtë janë disa shembuj nga vendet e Amerikës Latine:

Dhoma e Deputetëve, Parlamenti Brazilian - Platforma: e-Democracia⁴⁰

Dhoma e Deputetëve e parlamentit të Brazilit ka një portal virtual të pjesëmarrjes së qytetarëve, që i lejon përdoruesve të krijojnë tema diskutimi virtual dhe të marrin pjesë në diskutimin e agjendës legislative së bashku me parlamentarët. Portali i quajtur e-Demokracia ndahet në seksionet vijuese: debat interaktiv, opinione mbi nismat legislative, forma të tjera pjesëmarrjeje, statistika. Qytetarët mund të kontribuojnë duke komentuar apo votuar për nismat legislative që shqyrton Dhoma. Përveç projektligjit portali ofron një përmbledhje të tij në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun. Të gjitha komentet e bëra publikohen. Platforma ofron statistika të ndryshme dhe pyetje- përgjigje mbi përdorimin e saj. Një sistem ndjekjeje në lidhje me propozime të bëra nga publiku ofrohet nëpërmjet Buletinit Elektronik në të cilin mund të regjistrohesh lehtësisht.

⁴⁰ Shih platformën në linkun: <https://www.camara.leg.br/participe>

Dhoma e Deputetëve, Parlamenti Argjentinës - Platforma: Leyes abiertas⁴¹

Platforma Leyes Abiertas (ligje transparente) u krijua në partneritet të plotë me OSHC-të për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve që të votojnë dhe të paraqesin komentet/sugjerimet e tyre për projektligjet e propozuara nga deputetët. Parlamentarët postojnë projektligjet e tyre dhe ndjekin komentet e qytetarëve. Procesi i konsultimit ndodh përpara depozitimit të projektligjit në Dhomë. Përdoruesit publikë mund t'i shohin të gjitha projektligjet të hapura për koment, të komentojnë publikisht mbi to dhe të shohin komente të tjera që janë bërë. Platforma shihet si mundësuesi kryesor i transparencës legjislative.

Plani i Veprimit të Dhomës së Deputetëve “Për një parlament më të hapur” prezanton fushata ndërgjegjësuese në shkallë më të gjerë për të inkurajuar qytetarët që të përdorin më shumë platformën⁴². Qytetarët mund të bëjnë komente për çdo nen, çfarë duan të heqin, shtojnë apo modifikojnë. Projektligji në konsultim publik shoqërohet me një informacion të detajuar dhe të thjeshtë dhe të kuptueshëm për çfarë parashikon projekti. Të gjitha komentet janë publike. Modaliteti “Mbështes projektligjin” është lehtësisht i aksesueshëm. Detaj i rëndësishëm është koha e hapjes dhe mbylljes së konsultimit publik. Llogaria personale krijohet lehtësisht. Manuali i përdorimit⁴³ i publikuar në faqen e konsultimit jep informacion të detajuar, të thjeshtë dhe të kuptueshëm rreth përdorimit të platformës.

Republika e Kilit, Senati dhe Dhoma e Deputetëve – Platforma e Pjesëmarrjes qytetare (Kongresi Virtual)⁴⁴

Kongresi Virtual (KV) është një platformë dixhitale që synon të inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin legjislativ, duke lejuar përdoruesit e saj që të votojnë dhe komentojnë mbi nismat ligjore që publikohen aty. Platforma është disiplinuar me Rregulloren e Pjesëmarrjes Qytetare⁴⁵. Komisionet kryejnë konsultime publike për projektligjet ose çështje të natyrës legjislative brenda kompetencës së tyre. Platforma nëpërmjet seksionit pyetje-përgjigje jep shpjegime se si mund të regjistrohesh dhe se si të përdoret nga qytetarët. Detaj i rëndësishëm është koha e hapjes dhe mbylljes së konsultimit publik. Të gjitha komentet publikohen. Parlamentarët mbledhin komentet e paraqitura për të përmirësuar projektin. Platforma ofron

⁴¹ Shih platformën në linkun: <https://leyesabiertas.hcdn.gob.ar/>

⁴² Shih planin e veprimit në linkun: https://www2.hcdn.gob.ar/institucional/infGestion/congreso_abierto/index.html

⁴³ Shih manualin e përdorimit në linkun:

https://leyesabiertas.hcdn.gob.ar/static/files/congreso_manual_de_usuario.pdf

⁴⁴ Shih platformën në linkun: <https://congresovirtual.cl/projects>

⁴⁵ Shih Rregulloren, në linkun: <https://tramitacion.senado.cl/reglamento-de-participacion-ciudadana-del-senado> (Miratuar më 28.10.2020 nga Kongresi Kombëtar me propozimin e Komisionit të Etikës dhe Transparencës)

informacion rreth projektligjit në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme; qytetarët mund të votojnë edhe për komentet e njëri - tjetrit. Platforma ofron statistika dhe një raport përmbledhës mbi pjesëmarrjen e qytetarëve.

Platforma të tjera referimi mund të gjenden në adresat:

Finlandë

<https://www.lausuntopalvelu.fi/FI>

Portugali

<https://participa.pt/>

https://www.consultalex.gov.pt/Portal_Consultas_Publicas_UI/ConsultaPublica_Detail.aspx

Poloni

<https://www.gov.pl/web/development-technology/take-part-in-public-consultations-of-the-governments-law-making-process>

Çeki

<https://ctu.gov.cz/en/public-consultations>

Qipro

https://www.cyprus.gov.cy/moa/ëdd/ËDD.nsf/page41_en/page41_en?opendocument

Malta

<https://www.gov.mt/en/publicconsultation/Pages/default.aspx>

Kosova

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Skoci

<https://consult.gov.scot/>



REKOMANDIME PËR PLATFORMËN ELEKTRONIKE ONLINE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Instituti i Studimeve Politike (ISP), në vijim, paraqet disa rekomandime të cilat synojnë ta sjellin Platformën në përputhje të plotë me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Rekomandimet konsistojnë në përmirësimin e kuadrit rregullator si dhe të funksionaliteteve të kësaj faqeje interneti duke përdorur modalitete të reja teknologjike, të cilat do të lehtësojnë dhe për rrjedhojë do të fuqizojnë më tej pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e konsultimit publik por njëkohësisht edhe të shërbimeve të Kuvendit për raportimet e procesit.

1. **Kuvendi**, procesin e konsultimit publik nëpërmjet kësaj platforme, **mund dhe duhet ta disiplinojë me akt të posaçëm**, me rregulla të përcaktuara qartë lidhur me organizimin dhe funksionimin e platformës, çështjet që do t'i nënshtrohen konsultimit publik, subjektet pjesëmarrëse në konsultim, subjektet që autorizojnë këtë konsultim, afatin për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve, publikimin e dokumentit të konsultimit, publikimin e komenteve, raportin përmbledhës të konsultimit etj. Përshtatshmëria e kuadrit rregullator me praktikat më të mira ndërkombëtare gjeneron një proces më efektiv të konsultimit publik;
2. **Kuvendi mund dhe duhet të sigurojë që gjuha juridike apo teknike të mos shërbejë si pengesë për qytetarët** që kërkojnë qasje në informacionin parlamentar dhe veçanërisht në vendimmarrje. Pavarësisht domosdoshmërisë së përdorimit të terminologjisë juridike në hartimin e projektligjeve, Kuvendi duhet të hartojë përmbledhje të dokumentit të konsultimit në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për qytetarët. I nevojshëm do të ishte edhe ligji i përditësuar;
3. Kuvendi gjatë procesit të konsultimit publik duhet të bazohet jo vetëm në parimin e **pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe mosdiskriminimit** në pjesëmarrje, por mbi të gjitha në **parimin e transparencës**. Në respektim të këtij parimi, Kuvendi, duhet të bëjë transparent çdo mendim/sugjerim/rekomandim/shqetësim të subjekteve pjesëmarrëse në konsultimin publik si dhe të informojë publikun në mënyrë efektive;
4. Kuvendi mund dhe duhet të trajtojë në mënyrë të kujdesshme dhe transparente të gjitha **kontributet e marra gjatë një procesi konsultimi**. Kjo është thelbësore dhe krijon një bazë të mirë për bashkëpunimin e ardhshëm konstruktiv dhe marrëdhënie të frytshme me qytetarët/palët e interesuara. Publikimi i një përmbledhjeje të shkurtër mbi çështjet kryesore të ngritura në konsultim do të ishte pozitive;

5. Kuvendi mund dhe duhet të miratojë një **Plan Veprimi për të promovuar platformën e konsultimit publik në internet** në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për mundësitë që kanë për të kontribuar në konsultimet publike dhe për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Është e rëndësishme që të organizohen në mënyrë periodike aktivitete informimi në lidhje me promovimin e platformës. Këto aktivitete mund të organizohen me grupe specifike si media, OSHC-të dhe të rinjtë;
6. Kuvendi mund dhe duhet të **sigurojë zbatim efektiv të standardeve të procesit të konsultimit publik** duke përmirësuar funksionalitetet në platformë me krijimin e modaliteteve të reja. P.sh.,(1) të publikojë në platformën e konsultimit publik udhëzime të thjeshta dhe të kuptueshme mbi përdorimin e saj, (2) të krijojë lehtësira për publikun për sa i përket regjistrimit në platformë dhe hedhjes së komenteve. Kjo e afron qytetarin më pranë Parlamentit. (3) Të gjenerojë statistikën e nevojshme lidhur me procesin e konsultimit publik që platforma të jetë e besueshme: komentet (në total), numrin e komenteve nga individë, OSHC-të apo lobistë, subjektet më aktivë etj;
7. Kuvendi mund dhe duhet ta miratojë **raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në bashkëpunim me OSHC** si dhe të mbajë me to një konferencë vjetore të përbashkët për çështje të bashkëpunimit strategjik mes tyre (sikurse parashikohet).

